

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 341, Datë 23.12.2025

MBI

**PEZULLIMIN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-S LIDHUR
ME SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “BUSHTRICA 2017” SH.P.K. PËR
LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 66, pika 1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; nenit 14, pika 10, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.12.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2726/8 prot., datë 19.12.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “BUSHTRICA 2017” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “BUSHTRICA 2017” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2726 prot., datë 27.10.2025, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Bushtrica 2”, me kapacitet të instaluar 4,800 kW, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të lumit Bushtricë, në Qarkun e Elbasanit.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 283, datë 06.11.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 08.11.2025 dhe 10.11.2025) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 09.12.2025), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- ERE po ashtu ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e kësaj procedure, nëpërmjet shkresës nr. 2726/4 prot., datë 20.11.2025. Nga ana e MIE-s nuk ka pasur ndonjë qëndrim në lidhje me fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë.
- Me shkresën nr. 2726/3 prot., datë 13.11.2025, ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin e fillimit të procedurës dhe i ka kërkuar depozitimin e informacionit/dokumentacionit të aplikimit të konstatuar të paplotësuar ose të plotësuar pjesërisht.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2726/5 prot., datë 02.12.2025, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues, nga analizimi i të cilit u vlerësua e nevojshme zhvillimi i një komunikimi të mëtejshëm me qëllim sqarimin e dokumentacionit në lidhje me mbështetjen financiare si dhe depozitimin e planit të biznesit në format origjinal, pasi plani i biznesit i depozituar ishte në format fotokopje. Për këtë arsye ERE i është drejtuar shoqërisë nëpërmjet shkresës me nr. 2726/6 prot., datë 05.12.2025, duke i kërkuar depozitimin e sa më sipërcituar.
- Shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2726/7 prot., datë 12.12.2025, ka kërkuar pezullimin e shqyrtimit të aplikimit, deri në depozitimin e dokumentacionit të plotë.

Pezullimi i Afatit të Vendimmarrjes

- Në nenin 14, pika 10, të *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, *parashikohet se Bordi i ERE-s, rast pas rasti, pas fillimit të procedurës, mund të vendosë të pezullojë vendimmarrjen e tij.*
- Për gjithë sa më sipër, vlerësohet të pranohet kërkesa e shoqërisë dhe të pezullohet vendimmarrja e bordit të ERE-s për kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Bushttrica 2”, me kapacitet të instaluar 4,800 kW, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të lumit Bushttricë, në Qarkun e Elbasanit, deri në depozitimin e dokumentacionit në lidhje me mbështetjen financiare.

Me depozitimin dhe përditësimin e dokumentacionit të munguar dhe të nevojshëm nga ana e shoqërisë, do të rishikohet ky vendim dhe do të kryhet analiza përkatëse e dokumentacionit të aplikimit.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të pezullojë afatin e vendimmarrjes së bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë “BUSHTRICA 2017” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Bushttrica 2”, me kapacitet të instaluar 4,800 kW, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të lumit Bushttricë, në Qarkun e Elbasanit, deri në depozitimin e dokumentacionit të munguar.
2. Ky vendim është objekt rishikimi me depozitimin nga ana e shoqërisë të dokumentacionit të munguar.
3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “BUSHTRICA 2017” sh.p.k., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të

konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI